



Thirrje publike për pjesëmarrje në aktivitetin e projektit dhe marrjen e mbështetjes teknik

Në maj 2016 Konsorciumi EPTISA në bashkëpunim me MPPS ka filluar implementimin e projektit të financuar nga BE (IPA Komponenti 41) "Nxitja e ndërmarrjes sociale", me kohëzgjatje zbatimi prej 18 muajsh. Projekti fokusohet në rritjen e ndërgjegjësimit për ndërrarrjen sociale në shoqëri, si dhe nxitjen e një mekanizmi më efikas të bashkëpunimit midis partnerëve të ndryshëm. Ai ka për qëllim hartimin e masave të politikës në aspektet ligjore dhe financiare (Ligji për ndërmarrësi sociale), duke përcaktuar qasje në instrumentet financiare për ndërmarrjet sociale siç është kapitali fillestar, kreditë, mikrokreditë, subvencionet e BE-së për krijimin e vendeve të punës, duke krijuar njohuri mbi klauzolat e ndikimit social në prokurimin publik, etj.)

Objektivi i përgjithshëm i projektit "Nxitja e ndërmarrjes sociale" është "përmirësimi i inkluziviteti të tregut të punës, duke krijuar vende të reja të punës, nëpërmjet nxitjes së iniciativave sociale ekonomike". Qëllimi i projektit është që të "ndihmojë në zhvillimin e ndërmarrjes sociale në vend, duke krijuar ekosistemin e duhur për ndërmarrjen sociale". Qëllimi është të nxiten bizneset sociale tanimë të vendosura ose iniciativat start-up, duke iu ofruar shërbimet për mbështetje korporative".

Kjo është një thirrje për organizatat të cilat janë në fazën fillestare të krijimit të një ndërmarrje sociale ose ata të interesuar për të krijuar një ndërmarrje sociale (ju lutemi lexoni me kujdes kriteret e përzgjedhjes).

Përkrahja e ofruar për aplikantët/organizatat e përzgjedhura do të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve përmes mbështetjes teknike dhe jomateriale, trajnime të specializuara, dhe qasje bazuar në nevojat individuale të çdo aplikanti. Ekipi i projektit do të bëjë përpjekje për të lidhur aplikantët/organizatat e përzgjedhura me donator potencialë.

Trajnime të specializuara, që do synojnë nevojat e çdo organizate do të zbatohen nga ekspertë lokalë dhe do të bazohen në përvojën e modeleve pozitive të pranishme në vend. Qëllimi i tyre është të përmirësojë aftësitë e organizatave dhe t'i përgatisë për të vepruar si ndërmarrje sociale pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndërmarrësi Sociale.

Aplikimet e dorëzuara brenda afatit të paraparë do të vlerësohen nga një Komision i formuar për këtë aktivitet. Aplikimet do të vlerësohen në afat prej 7 ditëve pas afatit të dorëzimit. Në bazë të kriterëve të përcaktuar, do të përzgjidhen dhjetë (10) aplikantë / OSHC të cilat do të marrin mbështetjen e paraparë me projektin.

Afati i fundit për dorëzimin e Formularit të aplikimit në version elektronik nga aplikanti/organizata e interesuar është 10 mars 2017, ora 13.00, ne e-mail adresën në vijim socentremk@eptisa.com

Kriteret e përzgjedhjes dhe Formulari i aplikimit janë dhënë në dokumente të veçanta:

- **Kriteret e përzgjedhjes ENG, MKD, SHQ**
- **Formulari i aplikimit ENG**

¹ IPA Komponenti për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore / Programi Operativ për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore 2007-2013